



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:020461

Datë: 24.07.2018

Numri i dokumentit: 00088516

P. nr. 34/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës **A. D.** nga Gjakova, për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.8-6 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr.1427/17 të datës 10.01.2018, në shqyrtimin e fillestar të mbajtur më datë **17.07.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të dëmtuarve K. Xh, të miturve R. dhe A. P. dhe përf. ligjor prindi A. P. si dhe të akuzuarës A. I., te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **A. D.** nga Gjakova, Rr....., data e lindjes ... në Elbasan, R. e Shqipërisë, e bija e L. dhe e ëma S. e gjinisë B., ka të kryer shkollim universitar, amvise, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, në bshkësi martesore, nënë e 3 fëmijëve, me ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

-më dt.16.03.2017, rreth orës 13.00 min. në Gjakovë-, pikërisht në rrugën tranzite "...", rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 41 lidhur me nenin 255 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-088 dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e pasiguruar dhe të paregjistruar të markës "F. M.", me tar. të regj. . . ., me ngjyrë hiri, në drejtim të rrugës ". . ." me të arritur në afërsi të S. S., lëshon shiritin e rrugës duke kaluar në shiritin qarkullues me kahje të kundërt, ku me pjesën e përparme ballore të anës së majtë të automjetit të saj e godet në pjesën e përparme anësore të anës së majtë automjetin "P. " 206 me tar. të regjistrimit . . . ngjyrë hiri, të cilin e drejtonte K. Xh., i cili ishte në përball kalim në shiritin e majtë në drejtim të lëvizjes, i cili si pasojë e goditjes silltet për 180 shkallë duke dal nga rruga ku me pjesën e pasme të anës së majtë të automjetit e godet në pjesën e përparme të anës së majtë automjetin R. me tar. të regjistrimit me pronar D. S., i cili në momentin kritik ishte parkuar jashtë rrugës, me ç' rast si rezultat i këtij aksidenti përpos dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore pësojnë e pandehura dhe bashkudhëtarët e saj A. P. dhe R. P., ndërsa

lëndime të rënda trupore pëson i dëmtuari K. Xh., lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko—ligjore të Dr. F. D. të dt. 10.04.2017 dhe 11.12.2017.

- **me çka ka kryer veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8-6 të KPRK-s**

Gjykata në mbështetje të nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 ,74 dhe nenit 378/8-6 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarës i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej **14 (katërmbëdhjetë) muajve** , i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të dëmtuarit K. Xh. , të miturit R. dhe A. P. si dhe D. S. ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil .

Detyrohet e akuzuara që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **101.10 €** (në emër të ekspertizës së komunikacionit 51.10 euro dhe 50.00 euro në emër të ekspertizës mjeko-ligjore)si dhe në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej **20,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.427/17 të datës 18.01.2018, e ka akuzuar të akuzuarën A. D. nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8-6 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.17.07.2018, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë , Prokurori Ramiz Buzhala , lexoi aktakuzën PP/II.nr.427/17 të datës 18.01.2018, me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës por ne rreshtin e 4-ër pas fjalisë ne atë mënyrë qe “pa patentë “duhet te hiqet dhe te shtohet fjalët “ duke drejtuar automjetin te pasiguruar dhe te pa regjistruar” ndera pjesa tjetër mbete e pa ndryshuar.

E akuzuara A. D., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtoj se me pranimin e fajësisë jam e penduar për veprën e kryer nga pakujdesia , premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem më e kujdesshme, kërkoj falje nga të dëmtuarit për lëndimet e shkaktuara ku ne mesin e te dëmtuarave janë edhe familjaret e mijë , gjegjësisht fëmijë te mitur , andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë ,premtimin se në të ardhmen do të jem më e kujdesshme si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

I dëmtuari K. Xh. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarës dhe nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale ndërsa kompensim e demit do ta realizojë nga kompania e sigurimit.

Përf. ligjor prindi A. P. i te miturve A. dhe R. P. , deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale por kërkon kompensim demi te cilën do ta realizojë nga kompania e sigurimeve .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara A. D. : **më dt.16.03.2017, rreth orës 13.00 min.** në e Gjakovë-, pikërisht në rrugën tranzite”, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 41 lidhur me nenin 255 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-088 dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë , në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e pasiguar dhe të paregjistruar të markës “F.M.”, me tar. të regj, me ngjyrë hiri , në drejtim të rrugës “.....” me të arritur në afërsi të , lëshon shiritin e rrugës duke kaluar në shiritin qarkullues me kahje të kundërt , ku me pjesën e përparme ballore të anës së majtë të automjetit të saj e godet në pjesën e përparme anësore të anës së majtë automjetin “P “ 206 me tar. të regjistrimit ngjyrë hiri , të cilin e drejtonte K. Xh. , i cili ishte në përball kalim në shiritin e majtë në drejtim të lëvizjes, i cili si pasoj e goditjes sillet për 180 shkallë duke dal nga rruga ku me pjesën e pasme të anës së majtë të automjetit e godet në pjesën e përparme të anës së majtë automjetin R. me tar. të regjistrimit ... me pronar D. S. , i cili në momentin kritik ishte parkuar jashtë rrugës , me ç ‘rast si rezultat i këtij aksidenti përpos dëmeve materiale në automjete , lëndime të lehta trupore pësojnë e pandehura dhe bashkudhëtarët e saj A. P dhe R. P. ndërsa lëndime të rënda trupore pëson i dëmtuari K. Xh. , lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. F. D. ë dt. 10.04.2017 dhe dt.11.12.2017.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga e akuzuara pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarës formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarën ta shpalle fajtores dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarës ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit . Rrethana renduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të aktgjykimit ,ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marr parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga e akuzuara, personalitetin e te akuzuarës si nënë e 3 fëmijëve , pendimin e saj për veprën e kryer nga pakujdesia , kërkim faljen nga të dëmtuarit për lëndimet e shkaktuara ku dhe vet me dy fëmijë të saj të mitur kanë pësuar lëndime , sjelljen korrekte e të akuzuarës ne gjykim, premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jetë më e kujdesshme, deklarimi i përf. ligjor të dëmtuarve – të miturve se si dhe të dëmtuarit se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale si dhe faktin se është hera e parë që bie në ndesh me ligjin. Ne këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i saj qe te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm ,korrekte dhe e vetëdijshme për pasojat e shkaktuara, te cilat rrethana ndikuan qe gjykata ti zbatoj dispozitat e zbutjes se dënimit te parapara ne nenin 74 te KPRK-ës, kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht renduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar

dënim me burgim në kohëzgjatja prej 14(katërbëdhjetë) muajve ,i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2(dy) viteve , nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale ,do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë do të ndikoj tek e akuzuara që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej 110.00 € dhe paushalli gjyqësor në shumë prej 20,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 34/18 më datë 17.07.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatë së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.